



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

214/18
22.03.18

PSH. Nr. 214/18

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, në përbërje prej: z. Blerim Dina -Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z Goran Milenković - Anëtar, si dhe duke u bazuar në nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës dhe konform nenit 36 të Rregullores së punës së OSHP-së nr.01/2017, pas shqyrtimit të parashtrësën me nr. të protokollit 214/18, përmes së cilës autoriteti kontraktues (AK) TRAINKOS SH.A, paraqet kërkesë për marrjen eventuale të masave sipas dispozitave të LPP-së, për OE “Gredelj” Doo, - Zagreb, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Riparimi i Lokomotivave – Rifabrikimi, Furnizimi me vagon të përdorur të udhëtarëve me riparim të mesëm”, me nr. të Prokurimit: TRA/16/041/111, sipas arsyeve si ne vijmë: -AK kërkon marrjen e masave eventuale ndaj OE “Gredelj” Doo, - Zagreb, konkretisht kërkon qe ky operator ekonomik te futet ne liste te zezë ne kohë te pacaktuar për shkak te keqpërdorimit te informative zyrtare, me datën :20.03.2018, merr këtë :

V E N D I M

I. Refuzohet, si e pa bazuar, kërkesa e Autoritetit Kontraktues (AK) / TRAINKOS SH.A /, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik të OE “Gredelj” Doo, - Zagreb-Kroaci lidhur me procedurën e prokurimit me titull “ Riparimi i Lokomotivave – Rifabrikimi, Furnizimi me vagon të përdorur të udhëtarëve me riparim të mesëm”, me nr. të Prokurimit: TRA/16/041/111 dërtimi dhe mirëmbajtja e stacioneve të qytetit”, me numër të prokurimit: “614/17/026/536”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) / TRAINKOS SH.A

ARSYETIM

Organi Shqyrtues i Prokurimit, më dt. 21.02.2018, ka pranuar nga autoriteti kontraktues - Trainkos Sh.a., parashtrësën me nr. të protokollit 214/18, përmes së cilës autoriteti kontraktues - Trainkos Sh.a., paraqet kërkesë për marrjen eventuale të masave sipas dispozitave të LPP-së, për OE "Gredelj" Doo, - Zagreb, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Riparimi i Lokomotivave – Rifabrikimi, Furnizimi me vagon të përdorur të udhëtarëve me riparim të mesëm", me nr. të Prokurimit: TRA/16/041/111, sipas arsyeve si ne vijmë:

Autoriteti Kontraktues Trainkos Sh.a. ne kërkesën e datës 21.02.2018, kërkon marrjen e masave eventuale ndaj OE "Gredelj" Doo, - Zagreb, konkretisht kërkon që ky operator ekonomik të futet ne liste të zezë ne kohë të pacaktuar për shkak të keqpërdorimit të informative zyrtare.

Sipas autoritetit kontraktues, operatori ekonomik i lartpërmendur ka qene fitues i disa projekteve të autoritetit kontraktues.

Autoriteti kontraktues, ka pasur dyshime se një zyrtar i lart brenda autoritetit kontraktues ka pasur shkëmbim të informatave me përfaqësuesit e OE "Gredelj" Doo, - Zagreb, ku te njëjtit ky zyrtar i lart i AK-Trainkos Sh.a. i ka përgatitur edhe specifikimin teknik duke ja përshtatur OE "Gredelj" Doo, - Zagreb, ne mënyrë që i njëjti të përfitoj nga procedurat e prokurimit të AK-Trainkos sh.a..

Autoriteti kontraktues, lidhur me komunikimet e zyrtarit të lart të Trainkos-it, i është drejtuar organeve të hetuesisë, ku Gjykata Themelore ne Prishtinë – Departamenti për Krime të Renda e ka shpallur fajtor zyrtarin e lart të Trainkos-it, për veprën penale – Keqpërdorim i Informatës zyrtare sipas nenit 423 par.2 të KPRK-se.

Organi shqyrtues i Prokurimit me dt.05.03.2018, ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të përgatitur një kronologji për panelin shqyrtues lidhur me kërkesën e dt. 21.02.2018, të parashtruar nga Autoriteti Kontraktues Trainkos Sh.a.

Me dt.09.03.2018, eksperti i OSHP-se ka dorëzuar kronologjinë duke sqaruar si ne vijim:

Eksperti shqyrtues, sqaron se duke u bazuar ne të dhënat e me sipërme AK-Trainkos kërkon që edhe ndaj OE "Gredelj" Doo, të merren masat sipas dispozitave të LPP-se, përkatësisht të futet ne listën e zezë, me arsyetimin se OE "Gredelj" Doo dhe zyrtari i lart i Trainkos-it e kanë dëmtuar në masë të

madhe autoritetin kontraktues – Trainkos. Prandaj, AK-ja kërkon që ti ndalohet pjesëmarrja në aktivitet e ardhshme të prokurimit këtij operatori ekonomik.

Eksperti shqyrtues, lidhur me kërkesën e autoriteti kontraktues – Trainkos, sqaron se AK-ja, nuk ka dorëzuar asnjë provë se OE “Gredelj” doo, i cili gjatë pjesëmarrjes në ndonjë aktivitet të prokurimit pran autoritetit kontraktues – Trainkos, ka mashtruar apo ka falsifikuar ndonjë dokument apo dëshmi, për të cilën edhe OSHP, mund të merr masa konkrete ndaj ndonjë operatori ekonomik.

Eksperti shqyrtues sqaron se në nenin 99 të LPP-së, në të cilin flitet për funksionet dhe kompetencat e OSHP-së, në paragrafin 2, thuhet: Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 20.03.2018, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, eksperti shqyrtues e OSHP-së, përfaqësuesit e AK-së, OE është njoftuar nga AK-Trainkos dhe janë ftuar për seancën e sotme, të njëjtit nuk kanë arsyetuar mungesën e tyre dhe nuk ka bërë ndonjë kërkesë për shtyrje të seancës, seanca e sotme do mbahet pa praninë e përfaqësuesit të OE.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-Trainkos z.Zekaj deklaroi: Qëndrojmë pranë kërkesë tonë të datës 21.02.2018. Të gjitha detajet, provat dhe dëshmitë lidhur me këtë rast i gjeni në detaje në shkresa-kërkesën e AK-së për këtë lëndë. I propozojmë panelit të aprovoj kërkesën e AK-së si të bazuar dhe të ndërmerren masa konform dispozitave ligjore ndaj OE:”Gradelj Doo”.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të kërkesës së autoritetit kontraktues dhe arsyeshmërisë së dhënë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës dëgjimore konstaton se autoriteti kontraktues – Trainkos, AK-ja, nuk ka dorëzuar asnjë provë se OE “Gredelj” doo, i cili gjatë pjesëmarrjes në ndonjë aktivitet të prokurimit pran autoritetit kontraktues – Trainkos, ka mashtruar apo ka falsifikuar ndonjë dokument apo dëshmi, për të cilën edhe OSHP, mund të merr masa konkrete ndaj ndonjë operatori ekonomik.

Paneli shqyrtues është i obliguar që të merr masa ndaj operatorëve ekonomik vetëm nëse AK-ja, ka ofruar prova ashtu siç potencohet në nenin 99 të LPP-së, në të cilin flitet për funksionet dhe kompetencat e OSHP-së, në paragrafin 2 të këtij neni, ku thuhet: Në bazë të një kërkesë me shkrim nga

autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare, e që në rastin konkret AK-ja, nuk ka arritur të ofroj ndonjë dëshmi apo prove për paraqitje te dokumenteve te rreme apo të falsifikuara nga ana e OE Gredelj” Doo, - Zagreb-Kroaci.

Paneli shqyrtues, duke u mbështetur nenin 99.2 te LPP-së si dhe në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK - TRAINKOS SH.A

1x1 OE - "Gredelj" Doo, - Zagreb-Kroaci

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.